



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:080171

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05508285

P.nr.83/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm - Divizioni penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fatmire Podvorica dhe bashkëpunëtorin profesional Izet Hyseni, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. D. për shkak të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.3878/2023 datë 11.03.2024, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur më dt. 26.03.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit – Besart Mustafa dhe të akuzuarit, në të njëjtën ditë mori publikisht dhe shpalli Aktgjykimin, ndërsa me datë 27.03.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

A. D., nga i ati A. dhe nëna S., e vajzërisë M., i lindur më datë ..., me vendbanim në rrugën "A. K.", Komuna e Prishtinës, me numër personal, ka të kryer shkollën e mesme, profesioni programer, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike-financiare, Shqiptar-Kosovar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

I pandehuri, A. D. me dt. 12.05.2023, rreth orës 04:30, në rr, "I. Ko." në Podujevë pa autorizim ka poseduar substancë narkotike në atë mënyrë që zyrtarët policor e kishin ndaluar derisa kishte qenë duke udhëtuar me veturën e tipi te tipit Corsa, ngjyre hiri me targa në Podujevë, dhe se

gjatë kontrollit në veturën e tij kishin gjetur substanca narkotike e llojit marihuanë, me peshë të përgjithshme prej 0.54 gram.

- Me këtë ka kryer veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 2, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe nenit 269 të KPRK-së si dhe në bazë të neneve 242, 364, 365, 368, 369, 449, 452 të KPPRK-së

G J Y K O N

- I. Të akuzuarin e gjykon me dënim me gjobë në shumë prej 150.00 € (njëqind e pesëdhjetë/euro), të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 pesëmbëdhjetë ditësh, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.
- II. Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë pas afatit prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgimi, ashtu që për çdo 20€ (njëzet euro), të papaguara do t'i llogaritet 1 (një) ditë burg.
- III. Konform nenit 269 par. 3 të KPRK-së, të akuzuarit gjithashtu substanca narkotike e llojit marihuanë, me peshë të përgjithshme prej 0.54 gram, si mjet të kryerjes së veprës penale.
- IV. Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20.00€ (njëzet/euro), kurse në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 30.00 (tridhjetë/euro), të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën, PP.II.nr.3878/2023 datë 11.03.2024, kundër akuzuarit A. D. për shkak të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 26.03.2024 gjatë të cilës u dëgjuan Prokurori i Shtetit Prokurori i Shtetit Besart Mustafa nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe i akuzuari.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar ka bërë rikualifikimin e veprës penale ashtu që duhet të jetë në vend të paragrafit 1 duhet të jete par.2 sepse nga provat që gjenden ne shkresat e lëndës rezulton se pesha neton e narkotikut është 0.54 gram si dhe nga informacionet për të pandehurin nga Policia e Kosovës rezulton se i pandehuri nuk ka raste të tjera penale si dhe në përgjithësi dhe veçanti të veprave penale kundër narkotikëve.

I akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit deklaroi se: E pranoj fajësinë është hera e parë që jam para gjykatës, ky rast nuk do të përsëritet më asnjëherë, jam mbajtës i familjes, lus gjykatën që të me shqiptoi një dënim sa me të lehtë, i kërkoj falje shumë gjykatës dhe prokurorisë.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar dha mendimin se: Pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, sepse i njëjti është bërë me vullnetin e plotë nga i pandehuri dhe bazuar në shkresat e lëndës.

Gjykata pas pranimi të fajësisë nga ana e të akuzuarit si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, mbrojtësit të pandehurit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 242 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 242 par.6 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të të akuzuarit, përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penalo-juridik është përgjegjës, për çka të njëjtin e shpalli fajtor dhe iu shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari gjatë shqyrtimit fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila iu vihet në barrë, ndërsa si rrethanë veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti, andaj gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi mundësin e zëvendësimit të dënimit me gjobë, në dënim me burgim është marrë në kuptim të nenit 43 par.3 të KPRK-së.

Vendimi konfiskimin e substancave narkotike dhe gjësendeve tjera të mbajtura, në mënyrë të paautorizuar, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 269 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6 lidhur me nenin 452 par. 1 të KPPRK-së dhe vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË,
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal
P.nr.83/2024 me dt.27.03.2024**

G j y q t a r i

Minir Hoti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.